

17.03.2022

Ora 17:05

**RENDI I DITËS**

Projektvendim “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje, të datës 6 Mars 2022”.

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

• Komisioni Rregullator:

- |            |       |                    |
|------------|-------|--------------------|
| • Ilirjana | NANO  | Kryetar            |
| • Arens    | ÇELA  | Anëtar             |
| • Dritan   | ÇAKA  | Anëtar             |
| • Helga    | VUKAJ | Anëtar             |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar             |
| • Stafi    | KQZ   | Y. Merkaj, M. Koja |

Parti Politike: S’ka prezent

*Znj. I. Nano:* Mirëmbërëma! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme, datë 17 mars. Mbledhja është njoftuar zyrtarisht në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, gjithashtu njoftimi u është dërguar përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore. Në mbledhjen e Komisionit Rregullator marrin pjesë pesë anëtarët e Komisionit Rregullator, Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe zyrtarë të tjerë të administratës së KQZ-së. Në mbledhjen e sotme në rendin e ditës kemi vetëm një pikë. Kemi shqyrtimin e projektvendimit “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të pjesshme për kryetar, në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe

Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.17.03.2022*

Lushnje, të datës 6 Mars 2022”. Kolegë, sipas rregullores, më lejoni t’ju pyes nëse ka çështje jashtë rendit të ditës që doni të diskutoni? Nuk ka! Atëherë, fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit. Ky projektvendim ka ardhur me propozim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Do t’i lutesha Sekretarit të Përgjithshëm në mënyrë të përmbledhur, të paraqiste projektaktin. Zoti Merkaj!

**Z. Y. Merkaj:** Presidenti i Republikës ka caktuar datën 6 Mars 2022 për zhvillimin e zgjedhjeve të pjeshme vendore për kryetar bashkie, në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje. Referuar përcaktimit të nenit 2, pika 18, shkronja “b” dhe nenit 20, pika 2, shkronja “d” e Kodit Zgjedhor, Komisioni Rregullator shqyrton dhe miraton projektaktet e përgatitura nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në shkallë vendi, si dhe rezultatet e votimit për kandidat për kryetar bashkie, të cilët janë zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë në zonat zgjedhore përkatëse. Përsa më lartë në këtë relacion, në respekt të detyrimeve të afateve ligjore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, i propozojmë për shqyrtim dhe miratim Komisionit Rregullator, projektvendimin “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të pjeshme për kryetar bashkie, në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje të datës 6 Mars 2022”.

Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zoti Merkaj! Fillojmë shqyrtimin në parim të projektvendimit. Paraprakisht më lejoni t’ju them që mbas zhvillimit të zgjedhjeve të datës 6 Mars 2022, në gjashtë bashkitë, Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje, u zhvilluan zgjedhjet për kryetar bashkie sipas urdhërimeve të dekretit nr. 13 438, datë 20.01.2022, të Presidentit të Republikës. Pas zhvillimit të zgjedhjeve sigurisht janë zhvilluar dhe procese të tjera që lidhen me numërimin, nxjerrjen e tabelave përmbledhëse dhe në datën 9 mars 2022,

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.17.03.2022*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka miratuar 6 (gjashtë) vendime, për bashkitë Shkodër, Durrës dhe Lushnje, të cilat kishin më tepër se një KZAZ, ka miratuar tabelën përmbledhëse të rezultateve të KZAZ-ve dhe ka dhënë mandatin për kandidatët fitues. Ndërkohë në bashkitë Dibër, Vorë dhe Rrogozhinë, të cilat kishin një KZAZ, nga ana e KZAZ-së përkatëse është shpallur fituesi dhe me vendim të Komisionerit është dhënë mandati për kandidatët fitues. Ky projektvendim vjen në kohën kur ka përfunduar afati i ankimeve dhe doja të theksoja që nuk ka patur ankime ndaj vendimeve të Komisionerit, të gjashtë vendimeve që unë citova, të datës 09.03.2022. Afati i ankimit ka përfunduar para dy ditësh dhe sot është momenti për të shqyrtuar dhe miratuar vendimin për shpalljen e rezultatit përfundimtar. Kolegë, nëse keni diçka në parim lidhur me projektvendimin? Nëse jo, kalojmë në votimin në parim të projektvendimit.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundra: S'ka***

Me 5 vota pro, miratohet!


Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit, i cili ka 3 pika.

Pika 1. Komisioni Rregullator vendosi:

1. Të shpallë rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të pjeshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje, të datës 6 Mars 2022, si më poshtë vijon:

- a) Zoti Bardh Ali Spahia, kandidat fitues për kryetar të Bashkisë Shkodër, Qarku Shkodër, i propozuar nga koalicioni "Shtëpia e Lirisë";
- b) Zoti Rahim Petrit Spahiu, kandidat fitues për kryetar të Bashkisë Dibër, Qarku Dibër, i propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë;
- c) Zonja Emiriana Hiqmet Sako, kandidat fitues për kryetar të Bashkisë Durrës, Qarku Durrës, e propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë;

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.17.03.2022*

ç) Zoti Blerim Rustem Shera, kandidat fitues për kryetar të Bashkisë Vorë, Qarku Tiranë, i propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë;

d) Zoti Edison Selman Memolla, kandidat fitues për kryetar të Bashkisë Rrogozhinë, Qarku Tiranë, i propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë;

dh) Zonja Eriselda Musa Sefa, kandidat fitues për kryetar të Bashkisë Lushnje, Qarku Fier, e propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

Kolegë, lidhur me pikën 1 të projektvendimit, kemi diçka? Jo! Kalojmë në votimin e pikës 1.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundra: S'ka***

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundra: S'ka***

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundra: S'ka***

Me 5 vota pro, miratohet!

Atëherë do duhet të kalojmë dhe në votimin në tërësi të projektvendimit, pasi e kemi votuar atë në parim dhe nen për nen! Edhe njëherë kolegë, ju lutem!

***Kush është dakord në tërësi, me projektvendimin?***

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.17.03.2022*

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Dhe me shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të pjesshme për kryetar në 6 (gjashtë) bashkitë që u zhvilluan në datën 6 Mars 2022, mund të konsiderohet i përfunduar procesi zgjedhor për këto zgjedhje. Ju falenderoj! Nuk kemi pikë tjetër në rendin e ditës për të shqyrtuar, kështu që mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

**Vendim nr. 26**

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*

